



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

URDHER

Nr. 426 datë 01.12.2015

NR. 1772 PROT.
DATA 01.12.2015

PËR
MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE PËR TARIFAT E VEPRIMTARISË KRYESORE
TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

Ne vijim të memos 4613/1, datë 21.10.2015 të Drejtorisë Juridike dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Kulturës, në mungesë të një bazë ligjore specifike për të hartuar një projektvendim për miraim tarifash, si dhe duke qënë se mbledhja e traifave që vinë nga veprimtaria kryesore e Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" (IMK), sjell efekte pozitive për buxhetin e shtetit;

KONSTATOVA:

Se është e nevojshme nxjerrja e nje urdhri për rregullimin e veprimtarisë me efekt pozitiv financiar,

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

URDHEROJ:

1. Mbledhjen e të ardhurave për tarifat e veprimtarisë kryesore të Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" (IMK), për Liçenca profesionale dhe Liçenca profesionale për shoqëri ndërtimi ne restaurimin e monumenteve të kulturës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Të vijohet mbledhja e të ardhurave nga veprimtaria kryesore e Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" (IMK), deri ne rregullimin e situatës ligjore specifike me hyrjen ne fuqi të ligjit te ri "Për trashëgiminë kulturore".
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Disveristetin Kulturor për njoftimin e këtij Urdhri.
4. Ngarohet Instituti i Monumenteve te Kulturës "Gani Strazimiri" per zbatimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Mirela KUMBARO



Adresa: Rruga Aleksandër Moisiu, nr 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re" Tiranë
Email: info@kultura.gov.al
www.kultura.gov.al

Kela
Stebe
02.12.2015



Shërbime nr.1

TARIFA PËR LICENSAT PROFESIONALE QË MIRATON KËSHILLI KOMBËTAR I
RESTAURIMEVE

Nr.	Tarifa për shërbime që lidhen me detyrat funksionale të institucionit	Tarifa në Lekë	Afati Kohor në Ditë
1	Liçensë profesionale personale: A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale. C. Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi.	6 000	30
2	Liçensë profesionale për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës: A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale. C. Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi.	20 000	30
3	Për ndryshim të drejtuesit teknik restaurator	20 000	30



Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu"
Nr. 76, ish Kinostudio
Tiranë, Shqipëri
Tel.: +355 4 24 55 706 / +355 4 45 04 152
www.imk.gov.al

